

FJALA E DEPUTETIT AGRON GJEKMARKAJ

E ENJTE 3 SHKURT 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë!

Politika jonë e jashtme, në fakt, është e brendshme dhe ajo e brendshme nuk u bë kurrë e jashtme. Në gjuhën e saj të trashur si salep nga moskonsiderimi, ajo di vetëm të thotë: "Dobro jutro e buona sera, dobro vece e kalimera, good mornig e akshamllar, habituni ju, o shqiptarë."! Që kur u bë shteti ynë i vogël, i gjymtuar nga copëtimi, një kompleks provincial, prej të cilit nuk ndahemi dot, erdhi vetëm duke u harlisur si kungulli në bahçe; ai i udhëheqësve shpesh gjakatarë, dordolecë e matrahulë për t'u bërë kinse fanar ndriçues, magjepsës, aq sa i lënë pa frymë të huajt, me dije e sharm, me tollume e qillota, me citime e fjalë të kota. Tepër të gjatë e madhoshë për t'u larë në përroskën e vogël me ujë të ndenjtur të atdheut lundrojnë në detet e diplomacisë botërore, si flota e Kristofor Kolombit. Në pamundësi për t'i ndërruar imazhin një shteti të përzhitur nga historia, korrupsioni e banaliteti, vënë shtetin në dispozicion të imazhit personal për t'u kthyer në vatan të rruar e të qethur, allafrënga, me fotografi, gazeta e intervista që i madh e i vogël të mbajë frymën e të ndryshojë rrymën. Në vend që të bëjnë markë shalqinj të Torovicës, mollët e Dibrës e të Korçës, djathin e Gjirokastrës e domatet e Lushnjës, fiqtë e qeverisë duan të shndërrohen vetë në markë, në brend, në trend, vasalë andej e bimbashë arrogantë këtej, gaztorë matanë e të murrëtyer në këtë anë. Zero, zero, zero probleme me fqinjët, u tha dikur me piskamë e zenit. Ja ku jemi, te zerimi i problematikes me Greqinë. Kemi hequr dorë nga paketa e problemeve, nga trajtimi i tyre, pasi ju tregoi i madhi, se si Athina fliste shqip e me pas Gjergj Dushmani kapedani e shpëtoi atë nga jatagani e gazepi i flakëve.

Më pas, gjithçka u zgjidh në mënyrë të njëanshme, çdo gjë siç e duan ata. Çështja e detit u stis e u bitis që ne të dukeshim interesantë në konfliktin turko-grek, kur, në fakt, u gjendëm mes dy kuajve, që ndeshen në lëmë, e morëm shkelma pa fund. Presim mëshirën e Dendiasit apo Micotaqit për të marrë vesh ndonjë lajm apo vazhdimin e çështjes, se këtu është mbajtur sekret gjithë ai ibret. Kot shkuan edhe bisedat pleqërishte të Ditmirit me Kociasin e buzëqeshur e babaxhan që rrinte ndanë zjarrit si jaran. Ulja në dukje e retorikës midis dy vendeve është shoqëruar me tërheqje, me lëshime ndaj dramës çame dhe me braktisje ndaj halleve e kërkesave të emigranteve. Harresa ndaj ligjit të luftës u pa si e vetmja rrugëdalje nga premtimet e shumta për heqjen e tij, por ai rri ende i shkruar si monument turpi e kërcënimi i së shkuarës, një fenomen që po spikat prej disa vjetësh, po rritet si shtogu në plehun e mediokritetit dhe vetëmburrjes. Personalizimi i marrëdhënieve dypalëshe me shtetet u shoqërua me mungesën e memorizimit dhe informacionit zyrtar nga institucionet përkatëse. Një rendje, një turravrap për të hequr dorë nga angazhimi shumëpalësh në rajon nëpërmjet nismave rajonale, si CEFTA etj., duke i zëvendësuar me "Open Balkan", objekt konflikti me Kosovën dhe vendet e tjera fqinje, ka marrë trajtë të plotë. Druzhe Vuçiçi është bërë vëlla dhe Albin Kurti është bërë komshi.

Një mungesë transparence se si bëhet politika e jashtme na shfaqet në çdo kërkim. Hartohen dhe firmosen marrëveshje mes shtetesh pa një konsultë paraprake dhe pa marrë mendimin e institucioneve. Për më tepër, opozita e opinionin publik anashkalohen, a thua se janë tenderë rrugësh apo tenderë sekretë ilaçesh! Diplomacia merret me kurimin e brendit, imazhit të Kryeministrit, dhe

aspak me zbatimin e një politike të jashtme aktive. Prej vitesh shumicës se ambasadorëve u ka kaluar mandati në detyrë dhe askush nuk kujtohet për t'i ndërruar. Vlerësimi që ka pushteti për ta është si për një tufë azilantësh diplomatikë, për të cilët ne paguajmë taksa dhe qeveria i përdor si mazhordomë lepe-peqe në udhëtimet e saj enigmatike, ekzotike dhe aspak ekonomike. "Ambasada e zulluve në Paris", të jetë shkruar për ne?! Ndoshta. Në Vatikan, në një shtet kaq të rëndësishëm në diplomacinë botërore prej 8 vjetësh, nuk kemi ambasador dhe ky është mosvlerësim, fyerje për kontributin historik qysh nga koha e Skënderbeut që ky vend ka dhënë për ne. Jemi në kufijtë e atentatit ndaj interesave kombëtare. Marrëdhëniet ndërkombëtare prej kohësh janë monopol i Kryeministrit, i cili gjithë politikën e tij të jashtme e bazon tek e ashtuquajtura diplomaci personale. Kjo ka bërë që aksi i marrëdhënieve tona tradicionale me fqinjët të lëkundet dhe të krijojë trazime.

Fjala vjen, Kryeministri ynë, duke lënë prej disa vitesh në hije Ministrinë e Punëve të Jashtme, ka vendosur një standard marrëdhëniesh dypalëshe me Serbinë, të cilat kanë tejkaluar jo rrallë marrëdhëniet tona me Greqinë, Italinë, Maqedoninë e Veriut e se fundi edhe Kosovën. Qëkur Kryeministri u bë kryediplomat, edhe ligji për shërbimin e jashtëm ndryshoi për t'i dhënë atij gjitha kompetencat dhe askush nuk ka mekanizmat e mundësinë për të bërë një bilanc të politikës sonë të jashtme. Kjo qeveri e ka problem transparencën, dhe për këtë mjafton të shikosh arkivin e mjerë të njoftimeve, që nuk thotë asgjë për marrëveshjet që nënshkruhen. Për të mësuar mbi to, ndonjëherë duhet të shohësh faqet zyrtare të ministrive të fqinjëve. Kostoja e interesit kombëtar dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë është shume më e lartë se çdo tender dhe koncesion që jep kjo qeveri. Unë mendoj se ka ardhur koha që jo vetëm ne si parlamentarë, por e gjithë shoqëria t'i kërkojë një bilanc politikës sonë të jashtme në lidhje me efektshmërinë e saj në marrëdhënie me fqinjët dhe partnerët tanë. Politika e jashtme e Shqipërisë ka nevojë të rikthehet në shinat institucionale dhe të ketë llogaridhënie e transparencë për hapat që bëhen në emër të vendit tonë. Me këtë rast, duke i falënderuar diplomatët tanë, që nuk u bënë pengesë për bazën e Kuçovës, si dhe duke i uruar suksese misionit tonë në OKB, në përmbushje të mandatit si anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit, do të kërkoja më shumë seriozitet dhe përkushtim në mbështetje të Kosovës! ‘

Ne fund, siç e do zakoni, ju përshtendës të gjithëve, për meditim dhe jo akuzë, me vargjet e Konicës: "Se kanë dalë ca zuzarë/ që u lindën shqiptarë/ e punojnë natë e ditë/ që të mbetemi pa dritë./ Është turp prej kesi krimbash/ të mundohet një komb trimash." Faleminderit!